RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

# Komunikatë

## Rikonstituohet Bordi i RTK-së, Besnik Boletini rizgjedhet si kryetar

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dëshiron të njoftojë publikun për rizgjedhjen e z. Besnik Boletini dhe znj. Arta Berisha nga Kuvendi i Kosovës, si anëtarë të Bordit të RTK-së me mandat shtesë 3-vjeçar.

Në mbledhjen e Bordit të zhvilluar me datë 18 mars 2024, në përputhje me Ligjin për RTK-në, Statutin e RTK-së dhe Rregulloren e punës së Bordit të RTK-së, anëtarët e Bordit kanë rizgjedhur për kryetar të Bordit të RTK-së z. Besnik Boletini për një mandat shtesë.

Z. Besnik Boletini ka qenë në këtë detyrë për një mandat 2-vjeçar deri në dhjetor 2023, kur mandati i tij ka përfunduar. Duke filluar nga data 18 mars 2024, Bordi i RTK-së do të vazhdojë punën nën udhëheqjen e z. Besnik Boletini si kryetar, ndërsa znj. Albulena Mehmeti nënkryetare.